

MONOGRAFIA “BANESAT SHQIPTARE ME QOSHK” E PROF. EMIN RIZA

– Dëshmi e zhvillimit të arkitekturës shqiptare –

Prof. Dr. Emin Riza është një ndër emrat më të shquar të restauruesve shqiptarë dhe njohës i mirë i monumenteve kulturore në Shqipëri. Me një eksperiencë të gjatë pune në Institutin e Historisë dhe të Gjuhësisë, apo si specialist restaurues në Institutin e Monumenteve të Kulturës, fitoi një përvojë të madhe në fushën e ndërtimeve të vjetra, gjë që i shërbeu edhe për realizimin e 18 monografive. Duke qenë për disa vite kryeredaktor i revistës “Studia Albanica” dhe “Monumentet”, botoi edhe një sërë artikujsh në këto dy revista. Akademiku Emin Riza njihet si nismëtar dhe pjesë e grupit të punës së Ligjit “Për trashëgiminë kulturore” dhe kryesues i grupit të punës që përgatitën dosjen e Gjirokastrës dhe Beratit për në UNESCO, si pasuri botërore. Ka marrë vlerësime të shumta, mes të cilëve edhe “Qytetar Nderi” i Gjirokastrës dhe i Beratit.

Monografia e tij me titull “Banesa shqiptare me qoshk”, botuar në fund të vitit 2018, nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, përbën një studim që përmbush nevojën e trajtimit të veçantë të kësaj lloj banese, për të shtjelluar më gjerësisht vlerat kompozicionale të elementeve arkitekturore, strukturave teknike, materialeve ndërtimore etj. Në pesë kapituj shtjellohet evoluimi i banesave popullore shqiptare, deri në tipin më të ri, atyre me qoshk. Pasi flet mbi ecurinë e veprimtarisë studimore në fushën e banesës popullore shqiptare, autori e trajton qoshkun në rrafshin kompozicional, arkitekturor dhe teknik. Më pas përqendrohet në tiparet dhe llojshmërinë e banesës qytetare me qoshk në Shqipëri e Kosovë. Në fund, ndalon në përhapjen e banesave me qoshk në hapësirat shqiptare dhe ballkanike.

- Kapitulli i parë: Studimet e banesës popullore shqiptare
- Kapitulli i dytë: Qoshku, hapësirë funksionalo-arkitektuore
- Kapitulli i tretë: Tipi i banesës me qoshk në Shqipëri e Kosovë
- Kapitulli i katërt: Banesa popullore shqiptare dhe banesa që kanë qoshk

- Kapitulli i pestë: Përhapja e banesës me qoshk në Shqipëri, Kosovë dhe vendet ballkanike

Libri përmbillet me listën e punimeve studimore e shkencore të akademikut Emin Riza, ku spikatin monografitë, artikujt shkencorë dhe kumtesat në konferenca ndërkombëtare. Ai shoqërohet me dëshmi fotografike, vizatime e skicime që lehtësojnë përvetësimin e tekstit dhe krijojnë një ide më të qartë mbi këtë studim, ku paraqiten shembujt më të spikatur e më tipikë të banesave me qoshk në trojet shqiptare.

Duke e konsideruar studimin e ndërtesave të vjetra, si pjesë e pandarë e trashëgimisë sonë materiale e kulturore, autori risjell në vëmendje interesin e treguar nga udhëtari Evlija Çelebi, i cili në shkrimet e veta, gjatë udhëtimit nëpër Shqipëri në shek. XVII, shfaqti interes të veçantë për tipologjinë dhe zhvillimin e banesave shqiptare, si treguesi më efektiv për të kuptuar edhe më mirë shkallën e zhvillimit ekonomiko-shoqëror të shqiptarëve.

Krijimtaria e mjeshtërve popullorë shqiptarë në fushën e ndërtimeve përfshin vendbanimet, ngrëhinat ekonomike, ujësjellësit, çezmat, pazaret, hanet etj. Banesa popullore shqiptare në hapësirën e Republikës së Shqipërisë i ka fillesat sistematike të trajtimit rreth viteve 1965, me krijimin e Institutit të Monumenteve të Kulturës. Fillesat krahasimisht të vona për trajtimin e një fushe ndërtimore si banesat, patën përparësinë e mëvetësimit të arritjeve në këtë fushë. Ndarja e studiuesve sipas fushave përshpejtoi ndjeshëm ecurinë e punës kërkimore në funksion të banesës popullore shqiptare. Studimet mbështeten kryesisht mbi banesat ende të ruajtura, që përgjithësisht i përkasin shek. XIX-XX. Këto banesa shtrihen në mbarë trojet shqiptare, madje edhe në Serbi, Mal të Zi, Maqedoni dhe Greqi. Mbetet detyrë e brezave studiues pasues, që të kryejnë sa më parë hulumtimin dhe studimin e kësaj pasurie unike.

Studimet e derisotme janë të një vlere të madhe, sepse mbështeten në dokumente të mirëfillta historike. Këto ndërtime janë të lidhura ngushtë me zhvillimin ekonomik të një popullsie, çka kushtëzon edhe tiparet thelbësore të një banese. Sensibilizimi për banesën familjare me qoshk në Shqipëri, është vlerësuar rreth viteve 70 të shekullit të kaluar, fillimisht në Korçë. Qoshku është një element ndërtimor i cili ka një funksion të gjerë dytësor dhe vlere të spikatura arkitekturore. Zakonisht, vendoset anash banesës ose ngjitur me sallonet qendrore të katit të parë dhe katit të dytë. Ai gjendet dendur në banesat me çardak, me hajat, në banesat gjirokastrite dhe në kullat e Alpeve.

Siç nënvizon edhe autori në librin e tij, deri më sot, si datën më të hershme të ndërtimit të një banese me qoshk, njohim vitin 1764, konkretisht banesa e miqve të familjes së Toptanëve, në Kalanë e Krujës. Më pas, ky lloj ndërtimi u përhap gjerësisht, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë. Megjithatë, trysnia e kohës, katastrofat natyrore dhe njerëzore, si tërmetet dhe zjarret, patën pasoja dëmtuese, deri shkatërruese të banesave. Kjo solli rindërtime të pjesshme dhe rrallëherë tërësore të banesave të vjetra, si edhe shtesa të improvizuara. Për rastin në fjalë, shumë banesa me qoshk u modifikuan, duke e mbyllur qoshkun, për të plotësuar nevojat familjare në rritje numerike dhe të kërkesave jetësore. Kjo është një ndër arsyet që në ditët e sotme është mjaft e vështirë të evidentojmë banesa monumentale tipike shqiptare ekzistuese, ndaj, në mungesë të tyre, Profesor Emin Riza na sjell foto të hershme dhe planimetri të banesave popullore me qoshk. Njohuritë e thella në fushën e arkitekturës dhe të ndërtimit ai i shfrytëzon më së miri, duke shpjeguar me një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme për lexuesin.

Prof. Dr. Emin Riza mbetet mjaft aktiv edhe në ditët e sotme, për kontributin e tij të madh në misionin e ruajtjes së monumenteve të kulturës dhe banesave të vjetra, si pjesë e pandarë e trashëgimisë sonë materiale. Këtë shqetësim ai e ngre edhe në këtë libër, ku thekson: “Ndërtimet e kultit apo kalatë mbrojtëse përgjithësisht ruhen në rrjedhën e kohës për funksionin që ato kryenin dikur, ndërsa banesat popullore, pavarësisht rëndësisë së tyre, janë pre’ e natyrshme e zhvillimeve jetësore dhe e ndryshimeve, prandaj mbrojtja dhe ruajtja e tyre është e një rëndësie të veçantë”.

Autori e konsideron monografinë “Banesa popullore shqiptare me qoshk”, si përmbyllje të veprimtarisë së tij 55-vjeçare të pandërprerë vlerësuese të ndërtesave në hapësirat e Shqipërisë dhe Kosovës.